



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



01-05

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110, dt. 31.05.2012, nenit 13 dhe 14 të Ligjit të Procedurës Administrative, nr. 02/L-28, dt. 22.07.2005, nenit 17, al. 1, pika "b", "d" dhe "e" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dt. 20.02.2008, neni 57, pika "c" e Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 110-391, dt. 25.02.2010, duke vendosur sipas kërkesës për leje ndërtimore nr. **05-351/02-641/17 të dt. 10.01.2017**, të pronarëve **Marash Krasniqi dhe Faton Jashanica** nga Prishtina, dhe investitorit "**Pozhegu Brothers**" **Sh.P.K**, me pronar Qemajl Pozhegu nga Gjakova, për lejimin e ndërtimit të ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, ndërtesa "B2", në kuadër të bllokut urban "b-05", të nëntërësisë urbane "B-1", të tërësisë urbane "B" të Planit Rregullues "Muhaxhirët" në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative merr këtë:

V E N D I M

I. I LEJOHET pronarëve **Marash Krasniqi dhe Faton Jashanica** nga Prishtina, dhe investitorit "**Pozhegu Brothers**" **SH.P.K**, me çertifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 70518805 dhe me pronar Qemajl Pozhegu nga Gjakova, sipas kërkesës për leje ndërtimore nr. **05-351/02-641/17 të dt. 10.01.2017**, lejimi i ndërtimit të ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, me etazhitet -2B+S+P+10, në kuadër të bllokut urban "b-05", të nëntërësisë urbane "B-1" të tërësisë "B" të Planit Rregullues "Muhaxherët" në Prishtinë, konkretisht në parcelën kadastrale nr. 10146-1 (që është rezultat i bashkimit dhe ndarjes së parcelave kadastrale 7385-2, 7385-3 dhe 7385-4), të evidentuar në çertifikatën e njësisë kadastrale P-71914059-10146-1, ZK Prishtinë.

II. Hartimin e projektit kryesor për ndërtesën investive nga pika I e këtij Vendimi, për fazën e projektimit-arkitekturës, elektrikës, hidrosanitare e makinerike e ka bërë "**Pozhegu Brothers**" **Sh.p.k**, me çertifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 70518805, me përbërje të ekipit projektues:

- Projektin e arkitekturës, Krenare Kadriu, ma.a;
- Projektin e ujësjellësit dhe kanalizimit, Agron Nagavci, i.d.h.;
- Projektin e instalimeve elektrike, Agim Binaku, i.d.e.;
- Projektin e instalimeve makinerike, Agron Pjaziti, msc.mek., ndërsa për fazën e strukturës/statikës "Building" **Sh.p.k** me çertifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 70921669 dhe me pronar Luan Dalipi, me hartues Rexhep Saliu, i.d.n për fazën e strukturës/statikës së ndërtesës.
- Elaboratin gjeomekanik, N.N.SH "Geokos A&A", me çertifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 70303516;
- Elaboratin e mbrojtjes nga zjarri, N.SH.T. "Vetëtima";
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe aplikimin e masave të efijencës së energjisë, "**Pozhegu Brothers**" **Sh.p.k**;
- Ashensorët elektrike, N.SH.T "LADI", me çertifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 70917920, me projektues Ahmet Shala i.d.m.

II. Bazuar në dokumentacionin ndërtimor-projektin kryesor të prezantuar, sipërfaqja e tërësisë-bruto ndërtimore e ndërtesës së planifikuar dhe lejuar për ndërtim, me destinim shumë banesor & afarizëm, si dhe hapësirat tjera përcjellëse, është **S=8429.80 m²**, me etazhitet -2B+S+P+10, gjegjësisht sipërfaqja e lejuar për ndërtim mbi kuotën 0.00 është **S=6160.00 m²** dhe sipërfaqe nëntokësore **S=2269.90 m²**, me përmbajtje dhe sipërfaqe të etazheve, si në vijim:

- **Bodrumi -2**, me sipërfaqe të përgjithshme **S=997.50 m²**, me destinim dhe përmbajtje: hapësirë garazhuese, me sipërfaqe **S=826.10 m²** (29 vendparkime) dhe kthina teknike (depo) me sipërfaqe

$S=90.10 \text{ m}^2$, kthina për hidro dhe termoizolim me sipërfaqe $S=37.60 \text{ m}^2$ dhe hapësirë/bërthamë me komunikim, me sipërfaqe $S=43.70 \text{ m}^2$;

- Bodrumi -1, me sipërfaqe të përgjithshme $S=997.10 \text{ m}^2$, me destinim dhe përmbajtje: hapësirë garazhuese, me sipërfaqe $S=827.00 \text{ m}^2$ (27 vendparkime) dhe kthina teknike (depo) me sipërfaqe $S=107.70 \text{ m}^2$, kthina për hidro dhe termoizolim me sipërfaqe $S=18.70 \text{ m}^2$ dhe hapësirë/bërthamë me komunikim, me sipërfaqe $S=43.70 \text{ m}^2$;
- Sutereni, me sipërfaqe të përgjithshme $S=550.30 \text{ m}^2$, me destinim dhe përmbajtje: hapësirë për banim $S=257.70 \text{ m}^2$, hapësirë teknike (depo, etj) me sipërfaqe $S=138.30 \text{ m}^2$, hapësirë/bërthamë me komunikim, me sipërfaqe $S=50.30 \text{ m}^2$ dhe hapësirë për shumë qëllime, me sipërfaqe $S=104.00 \text{ m}^2$;
- Përdhesa, me sipërfaqe të përgjithshme $S=547.10 \text{ m}^2$, me destinim dhe përmbajtje: hapësirë për banim, me sipërfaqe $S=459.80 \text{ m}^2$ (4 banesa dydhomëshe, 1 banesë tridhomëshe e gjysëm, 1 banesë njëdhomëshe-garsonjerë), dhe hapësirë/bërthamë me komunikim, me sipërfaqe $S=87.30 \text{ m}^2$;
- Kati I-II-IV-V, me sipërfaqe të përgjithshme $S=553.00 \text{ m}^2$, me destinim dhe përmbajtje: hapësirë për banim, me sipërfaqe $S=488.50 \text{ m}^2$ (5 banesa dydhomëshe, 1 banesë dydhomëshe e gjysëm), dhe hapësirë/bërthamë me komunikim, me sipërfaqe $S=64.50 \text{ m}^2$;
- Kati III, me sipërfaqe të përgjithshme $S=553.00 \text{ m}^2$, me destinim dhe përmbajtje: hapësirë për banim, me sipërfaqe $S=488.50 \text{ m}^2$ (4 banesa dydhomëshe, 1 banesë njëdhomëshe e gjysëm, 2 banesa njëdhomëshe-garsonjerë), dhe hapësirë/bërthamë me komunikim, me sipërfaqe $S=64.50 \text{ m}^2$;
- Kati VI, me sipërfaqe të përgjithshme $S=550.90 \text{ m}^2$, me destinim dhe përmbajtje: hapësirë për banim, me sipërfaqe $S=486.40 \text{ m}^2$ (3 banesa dydhomëshe, 1 banesë njëdhomëshe e gjysëm, 3 banesa njëdhomëshe-garsonjerë), dhe hapësirë/bërthamë me komunikim, me sipërfaqe $S=64.50 \text{ m}^2$;
- Kati VII, me sipërfaqe të përgjithshme $S=546.30 \text{ m}^2$, me destinim dhe përmbajtje: hapësirë për banim, me sipërfaqe $S=481.80 \text{ m}^2$ (5 banesa dydhomëshe, 1 banesë dydhomëshe e gjysëm), dhe hapësirë/bërthamë me komunikim, me sipërfaqe $S=64.50 \text{ m}^2$;
- Kati VIII, me sipërfaqe të përgjithshme $S=534.90 \text{ m}^2$, me destinim dhe përmbajtje: hapësirë për banim, me sipërfaqe $S=470.40 \text{ m}^2$ (4 banesa dydhomëshe, 2 banesa njëdhomëshe, 1 banesë njëdhomëshe-garsonjerë), dhe hapësirë/bërthamë me komunikim, me sipërfaqe $S=64.50 \text{ m}^2$;
- Kati IX, me sipërfaqe të përgjithshme $S=513.50 \text{ m}^2$, me destinim dhe përmbajtje: hapësirë për banim, me sipërfaqe $S=449.00 \text{ m}^2$ (4 banesa dydhomëshe, 2 banesa njëdhomëshe-garsonjerë, 1 banesë njëdhomëshe e gjysëm) dhe hapësirë/bërthamë me komunikim, me sipërfaqe $S=64.50 \text{ m}^2$;
- Kati X, me sipërfaqe të përgjithshme $S=427.00 \text{ m}^2$, me destinim dhe përmbajtje: hapësirë për banim, me sipërfaqe $S=373.80 \text{ m}^2$ (3 banesa dydhomëshe, 1 banesë tredhomëshe e gjysëm) dhe hapësirë/bërthamë me komunikim, me sipërfaqe $S=53.20 \text{ m}^2$;

III. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumentacioni ndërtimor, Situacioni i lokacionit me objekt sipas vijës rregullative dhe asaj ndërtimore, qasjen kompleks, organizmin me vendparkime, plato, gjelbërim, etj., për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori, Dispozita Urbanistike e objektit me parcelën kadastrale në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01, e i cili do të shërbejë si bazë për relievimin gjeodezik të ndërtesës nga pika I. e këtij Vendimi, si dhe Kartela e inspektimeve të miratuara.

IV. Investuesi është i obliguar:

- Që të ruajë një ekzemplar origjinal të dokumentacionit ndërtimor në bazë të të cilit është dhënë kjo leje ndërtimi;
Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimit të kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
Të lajmërojë këtë Drejtori për ditën e fillimit të punëve ndërtimore, së paku 7 (shtatë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të fiksimit dhe piketimit të shtrirjes së objektit brenda lokacionit.
- Me rastin e lajmërimit të kësaj Drejtorie duhet të prezantohen:
 - Kontrata për firmën e punëve zbatuese, e licencuar.

- Kontrata për inxhinierin mbikëqyrës dhe inxhinierët ekspert për të gjitha fazat e ndërtimit, të licencuar.
 - Të njoftojë Drejtorinë e Inspeksionit 7 (shtatë) ditë para fillimit të punëve ndërtimore me qëllim të mbikëqyrjes inspektuese dhe të nënshkrimit të protokollove përkatëse mbi përfundimin e fazave respektive të ndërtimit
 - Që pas kryerjes së themeleve ta lajmërojë këtë organ, në mënyrë që të bëhet kontrollimi i ndërtimit të themeleve dhe konstatimi se ato janë ndërtuar në harmoni me kushtet ndërtimore dhe me projektin, dhe për këtë të merret vërtetimi me shkrim.
 - Të lejohen inspektorët të verifikojnë gjatë ndërtimit ose në çdo kohë pas kryerjes së ndërtimit të objektit, për të cilën është dhënë leje ndërtimi, se ndërtimi është kryer në bazë të lejes së ndërtimit dhe kushteve ndërtimore të caktuara.
- V. Investitori është i obliguar që materialet inerte që gjenerohen në fazën përgatitore dhe në fazën e ndërtimit të objektit (si: dheu, materialet ndërtimore, etj.) të barten në deponi për materiale të ngurta.
- VI. Investitori është i obliguar që pas përfundimit të punëve ndërtimore, të aplikojë te ky organ, për pajisje me Çertifikatë të përdorimit, konform me nenin 27 dhe 28 të Ligjit të Ndërtim nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012.
- VII. Në rast se gjatë ndërtimit bëhen ndryshime të projektit zbatues (gjatë realizimit të punimeve), investitori është i obliguar të prezantojë projektin e objektit në tërësi, sipas zbatimit.
- VIII. Leja e ndërtimit vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit, me të drejtë vazhdimi edhe për një vit tjetër.

A r s y e t i m

Pronarët **Marash Krasniqi** dhe **Faton Jashanica** nga Prishtina, dhe investitori "**Pozhegu Brothers**" SH.P.K, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 70518805 dhe me pronar Qemajl Pozhegu nga Gjakova, me kërkesën për leje ndërtimore nr. **05-351/02-641/17** të dt. **10.01.2017**, kanë kërkuar nga kjo drejtori, lejimin e ndërtimit të ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, me etazhitet - 2B+S+P+10, në lokacionin e përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtij Vendimi.

Bashkangjitur me kërkesë, pronarët dhe investitori, kanë prezantuar këtë dokumentacion:

- Projektin kryesor në tri kopje, dhe kopjen elektronike, në PDF dhe DWG;
- Kopjen e planit të parcelës kadastrale nr. 10146-0, evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale P-71914059-10146-0 ZK Prishtinë (kopje e vërtetuar nga origjinali, te noteri Sefedin Blakaj, Nr. i LRP-së: 10640/2016-akt en brevet, dt. 12.12.2016);
- Kopjen e planit të parcelës kadastrale nr. 10146-1, evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale P-71914059-10146-1 ZK Prishtinë (kopje e vërtetuar nga origjinali, te noteri Sefedin Blakaj, Nr. i LRP-së: 4513/2017-akt en brevet, dt. 12.05.2017);
- Kontratën mbi ndërtimin e përbashkët, e lidhur në mes të bashkëpronarëve Marash Krasniqi dhe Fetije Jashanica(Faton Jashanica), dhe "Pozhegu Brothers" sh.p.k. , me përfaqësues Qemajl Pozhegu nga Gjakova, përpiluar dhe vërtetuara te noteri Sefadin Blakaj, (akt en minute) Nr. i LRP. Nr. 6515/2014, Nr. REF: 1228/2014, dt. 30.09.2014 (kopje e vërtetuar nga origjinali);
- Aneks I-Kontratë mbi ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore ,kontrata me nr.LRP.6515/2014, dhe Kontrata me lrp.nr.1228/2014 dt.30.09.2014, përpiluar dhe vërtetuar te noteri Sefadin Blakaj, (akt en minute) Nr. i LRP. Nr. 2199/2016, Nr. REF: 380/2016, dt. 30.03.2016 (kopje e vërtetuar nga origjinali);
- Deklaratën/Pëlqimin e investitorit "Pozhegu Brothers " Sh.P.K, me pronar Qemajl Pozhegu nga Gjakova, dt. 23.05.2017 me të cilën jep pëlqimin llogaritja e taksës administrative dhe tarifës për dendësitet infrastrukturor,të bëhet bazuar në Vendimin për taksat administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifat për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës për vitin 2013, me nr. 01-016-30160 dt. 12.03.2013;
- Kushtet ndërtimore, me nr. 05-350-97110 të dt. 12.08.2016, të caktuara nga kjo drejtori;

- Kontratën për dhurimin e pjesës ideale të paluajtshmërisë dhe themelimin e bashkëpronësisë në mes të Fetije Jashanica –dhuratëdhënësjë dhe Faton Jashanica-dhuratëmarrësi, përpiluar dhe vërtetuar te noteri Sefadin Blakaj, , (akt en minute) Nr. i LRP. Nr. 9860/2016, Nr. REF: 1732/2016, dt. 23.11.2016 (kopje e vërtetuar nga origjinali);
- Pëlqimin paraprak për shpronësimin me kompensim të pjesës së parcelës kadastrale nr. 10146-0 ZK Prishtinë (7385-3 dhe 7385-2), 05 Nr. 351/02-641/17 dt. 09.02.2017, dhënë nga kjo drejtori;
- Marrëveshjen e arritur në mes të Komunës së Prishtinës, të përfaqësuar nga Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës, dhe pronarëve të parcelës kadastrale nr. 10146-0 ZK Prishtinë, Marash (Pal) Krasniqi, Faton (Emerzad) Jashanica, dhe “Pozhegu Brothers”Sh.p.k me përfaqësues Qemajl Pozhegu, për kompensimin e tokës private me koeficient të ndërtimit, sipas Pëlqimit Paraprak nr. 05 Nr. 351/02-641/17 dt. 09.02.2017 të Drejtorisë së Urbanizmit, me qëllim të ndërtimit të rrugës për interesin publik, 010 Nr. 464/01-37268/17 dt. 24.03.2017;
- Inçizimin gjeodezik të parcelave kadastrale nr. 7385-3, 7385-4 dhe 7385-2, të punuar nga gjeodeti i licencuar “Consult Engineering”SH.P.K, me licencë nr. 39;
- Vendimin e lejes së ndërtimit nr.05-351-102321 dhe 05-035-237989 dt.26.11.2014, të pronarëve Naim,Bashkim dhe Milaim Janova, Rahim dhe Aziz Kongjeli, Safet Ramadani,Xhemajl Gashi dhe “ Pozhegu Brothers “ SH. P.K nga Prishtina, të ndërtesës shumëbanesore, me etazhitet 2B+S+P+11, në parcelën kadastrale nr.10094-1 Zk Prishtinë, në bllokun “B-05” të nëntërësisë urbane “B1”në tërësinë urbane “B”, të Planit Rregullues “ Muhaxherët “, në Prishtinë;
- Vendimin për miratimin e kërkesës për Leje Mjedisore Komunale, 05 Nr. 501-227709, më 29.12.2016, lëshuar nga kjo drejtori;
- Pëlqimin në dokumentacionin investivo-teknik, Elaboratin e Mbrojtjes nga Zjarri, dhënë nga Inspektorët e Parandalimit dhe Hulumtimit të Zjarrit në DSHPMSH-Komuna e Prishtinës, nr. evidentues-228/1907 dt. 16.09.2016(kopje dhe e vërtetuar);
- Pëlqimin për gropim, nga “Termokos” sh.a., Ngrrohtorja e Qytetit, me nr. 1059 dt. 30.08.2016(kopje dhe e vërtetuar);
- Pëlqimin për dhënie e kushteve teknike nga KUR “Prishtina”, me nr. 2405/1 dt. 14.12.2016;
- Pëlqimin për rregullim të dokumentacionit teknik nga KEDS-i, me nr. 2477 dt. 10.03.2017(kopje dhe e vërtetuar);
- Pëlqimin nga telekomi i Kosovës, me nr.03-3353/16 dt. 07.09.2016(kopje dhe e vërtetuar);
- Proven mbi pagesën e këstit të parë të taksës administrative për leje të ndërtimit dhe tarifës për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës për vitin 2013, të llogaritur sipas Aktvendimit nr. 05-351/02-641/17 dt. 23.05.2017, e të paguar në bankën “Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.” Bank në Prishtinë, fatura me nr. të referencës: FT17146KHHBO, në shumën 58,644.71 euro;
- Deklaratat e garantuesit Kompania e Sigurimeve “Elsig” nga Prishtina, me nr. serik 0027280 dhe nr. 0027281, cili garanton për pagesën me kohë të obligimeve që rrjedhin nga Aktvendimi për leje të ndërtimit nr. 05-351/02-641/17 dt. 23.05.2017, si në vijim: kësti i dytë, në shumën prej 43,983.53 €, i cili skadon me 22.12.2017, dhe kësti i tretë, në shumën prej 43,983.53 €, i cili skadon me 26.06.2018 (kopje e përcjellë nga Drejtoria për Financa dhe Buxhet, përmes shkresës zyrtare nr. 010-452-01-124682/17 dt. 30.05.2017);
- Vërtetimin e tatimit në pronë të Qemajl Pozhegu, sipas kërkesës së “Pozhegu Brothers” Sh.p.k, me nr. 311224 dt. 22.12.2016;
- Vërtetimin e tatimit në pronë të Fetije Jashanica, me nr. 311265 dt. 22.12.2016;
- Vërtetimin se Marash Krasniqi nuk ka pronë të regjistruar, me nr. 311265 dt. 22.12.2016;
- Kopjet e letërnjoftimit të bashkëpronarëve dhe të investitorit.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në fazën e shqyrtimit të kërkesës me dokumentacionin e bashkangjitur, konsultimit të rregullativës ligjore në fuqi si dhe konsultimit të fazave paraprake lidhur me kushtet dhe obligimet e kërkuarit për plotësimin e kushteve të parapara ligjore për aplikim për leje ndërtimore, ka konstatuar si në vijim: bazuar në Kushtet Ndërtimore 05 nr. 350-97110 të

dt. 12.08.2016, kërkuesi obligohet që paraprakisht të bëjë bashkimin e parcelave kadastrale nr. 7385-2, 7385-3 dhe 7385-4, ZK Prishtinë, në një parcelë të vetme ndërtimore. Si procedurë tjetër paraprake obliguese, është realizuar edhe shpronësimi-kompensimi me koeficient ndërtimi i pjesëve të parcelave kadastrale në pronësi private, gjegjësisht sipërfaqja prej $S=105\text{ m}^2$, e përfshirë në rrugën e planifikuar, dhe kompensuar me sipërfaqe ndërtimore prej $S=420\text{ m}^2$, e cila procedurë është realizuar me "Pëlqim paraprak lidhur me parcelën kadastrale nr. 10146-0 (7385-3 dhe 7385-2) ZK Prishtinë, nga Plani Rregullues "Muhaxherët", 05 nr. 351/02-641/17 dt. 10.01.2017, të dhënë nga kjo drejtori, dhe realizimin e marrëveshjes definitive me Drejtorinë e Pronës të Komunës së Prishtinës, ku njëherësh është formuar parcela ndërtimore nr. 10146-1, me sipërfaqe prej $S=1435\text{ m}^2$.

Në vazhdim të shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të bashkangjitur, konkretisht dokumentacionit ndërtimor-projektit kryesor, në procedurë të rregullt, zyrtari përgjegjës i drejtorisë, siç përcaktohet në nenin 12,13 dhe 14 të UA 10/2013 dt. 04.06.2013, të njëjtin e ka dorëzuar tek zyrtarët përgjegjës për faza ndërtimore-"fazistat" e drejtorisë, për verifikimin e rregullsisë së dokumentacionit ndërtimor me kushtet ndërtimore, rregullativën ligjore në fuqi dhe plotësimin e normave dhe standardeve për këto lloje ndërtesash, të aprovuara përmes "Shqyrtim i aplikacionit për leje ndërtimore". Në ndërkohë, kërkuesit kanë prezantuar Deklaratën/Pëlqimin e investitorit "Pozhegu Brothers " Sh.P.K, me pronar Qemajl Pozhegu nga Gjakova, dt. 23.05.2017 me të cilën jep pëlqimin që llogaritja e taksës administrative dhe tarifës për dendësitet infrastrukturor,të bëhet bazuar në Vendimin për taksat administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifat për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës për vitin 2013, me nr. 01-016-30160 dt. 12.03.2013.

Pas procedurave të lartcekura, dhe miratimit të dokumentacionit ndërtimor-projektit kryesor, Drejtoria e Urbanizmit me Aktvendimin 05 Nr. 351/02-641/17 dt 23.05.2017, ka caktuar taksën administrative për dhënie e lejes së ndërtimit dhe tarifën për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës për vitin '2013, në shumë totale prej 146,611.77 €, me mundësi të realizimit në tri këste, ku këstin e parë në vlerë prej 58,644.71 e ka realizuar dhe dëshmuar përmes faturës, paguar në "Raiffeisen Bank" më datë 26.05.2017, dhe njëherë ka siguruar garancitë bankare për këstin e dytë dhe të tretë, të cilat janë konfirmuar edhe nga Drejtoria e Financave e Komunës së Prishtinës, 010 nr. 452-01-124682/17 dt. 30.05.2017.

Drejtoria e Urbanizmit, pas verifikimit të dokumentacionit të prezantuar, kontrollimit të tij nga zyrtarët e lëmit përkatës (kontrollimi i fazave të projektit-shqyrtimet e aplikacioneve për leje ndërtimore), prezantimit të pëlqimeve përkatëse në elaborate dhe kyçje në infrastrukturë, konstatimeve të lartcekura, zhvillimit të procedurave paraprake, kjo drejtori ka vërtetuar se kërkuesi dhe investitori kanë prezantuar tërë dokumentacionin e nevojshëm e të paraparë me rregullativën ligjore nga lëmi i ndërtimit dhe se i njëjti është në harmoni me kushtet ndërtimore dhe standardet tjera për llojin përkatës të ndërtimit.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Shtojcë: Situacioni i lokacionit me pozicionim të ndërtesës, Dispozita urbanistike e objektit parcelë kadastrale në sistemin koordinativ KOSOVAREF01 dhe Kartela e inspektimeve të miratuara.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendim, përmes kësaj Drejtorie, me ankesë mund t'i drejtohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi.

I dorëzohet:Kërkuesve/Investitorit, Drejtorisë së Financave, Drejtorisë së Inspektionit, Drejtorisë së Kadastrit, kësaj Drejtorie, në dosjen e lëndës dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

DREJTORIA E URBANIZMIT, E KOMUNËS SË PRISHTINËS,


05 NR. 351/02-641/17 DT. 14.06.2017

Punoi,
ark. Leonora Mehmeti, inxh. dipl.

Kontrolloji,
ark. Nazife Krasniqi, inxh. dipl.

Drejtori,
ark. Liburn Alija, inxh. dipl.









veriu

Hapsira e gjelbert

Vija e parcelles



Vija rregullative

Vija ndërfimore

Shtepite egzistuese

Objekti B2

Kontinieri i mbeturinave



POZHEGU BROTHERS



INVESTITOR
POZHEGU BROTHERS SH.P.K
EMERTIMI I PROJEKTI

LOKACIONI
LAGJE "MIRAHARRE"
BLOKU B5 JOZEF P
Prishtine

PERIPALJESIA
Projekti kryesor

SITUACIONI I NGUSHTE
1:200

FAZA E PROJEKTI
DATA
2017

ARKITEKTURA

PROJEKTOI:
KRENARE KADRIU Master
ELEZ PODRIMJA CanMaster

Handwritten signatures and initials.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo


Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



DREJTORIA E URBANIZMIT




DISPOZITA URBANISTIKE E NDËRTESESË ME PARCEL KADASTRALE NE SISTEMIN KOORDINATIV KOSOVAREF01



Punoi:
Kushtrim Domaneku, gjeod.

Ark. Leonora Mehmeti, Inxh. dip.

Legjenda:



Përdhesa e planifikuar

Bodrumi I planifikuar

Vija Rregulluese

Vija Ndërtimore

Parcelat Kadastrale

Prishtinë: 14.06.2017

Vendos këtë kartelë në vend të dukshëm



Mbani këtë kartelë për referencë.
Ky është historiku juaj i inspektimeve në terren.

Për inspektime thirrni: _____

Nr. i lejes: 05 NR.35/02-64/17 Data: 14.06.2017

Poseduesi i lejes: HARRASH KRASHIÇI DHE FATON JASHAVIÇA, ME INV. "POZHEGOBROTHERS"

Lloji i ndërtimit: NDËRTESË SHUMËMBANËSORE

Lokacioni: LASJA "MUHAXHERËT"

THEMEU		
Inspektimi	Nënshkrimi i inspektorit	Data
Themeli, lokacioni, format, përforcimi		
MOS HEDH BETON DERISA TË NËNSHKRUHET PJESA MË SIPËR		
Inspektimi i vendosjes së betonit		
INSTALIMET		
Inspektimi	Nënshkrimi i inspektorit	Data
Elektrika		
Hidroinstalimet		
Instalimet tjera		
SIGURIA NGA ZJARRI		
Inspektimi	Nënshkrimi i inspektorit	Data
FINAL		
Inspektimi	Nënshkrimi i inspektorit	Data